

## V E N D I M

Nr. 3 date 21.12.2021

### I mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "FYDA" sh.p.k.

Sot në datën 21.12.2021 u zhvillua mbledhja e Ortakeve të shoqërisë tregtare FYDA SH.P.K. me NUIS M12317004F të cilët janë:

- **Z. Alfredo Colangelo**, nënshtetas italian, i lindur në datën 07.12.1954 në Pescara.  
dhe
- **Z. Mohamed Dosukey Mohamed Ibrahim Aman**, nënshtetas egjiptian, i lindur në datën 17.11.1986 në Kajro.


Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në zbatim të nenit 17 të Statutit të shoqërisë, me unanimitet

#### Vendosi:


1. Të lirojë nga detyra e Administratorit **Z. Alfredo Colangelo** i cili aktualisht ishte një prej dy administratorëve të FYDA shpk.
2. FYDA shpk vijon të ketë si administratorë **Z. Mohamed Dosukey Mohamed Ibrahim Aman** i cili ushton i vetëm të gjitha detyrat dhe kompetencat e administratorit ashtu siç parashikohet në statut dhe legjislacionin në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
4. Autorizohet znj. Brisilda Sakiqi me numër personal J76206040A për të paraqitur dokumentacionin përkatës dhe kryer veprimet e nevojshme për regjistrimin e ndryshimit në Qendrën e Regjistrimit të Biznesit, brenda 30 ditëve.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Ortaku

  
Z. Alfredo Colangelo

Ortaku

  
Z. Mohamed Dosukey Mohamed Ibrahim Ama

**FYDA Sh.p.k.**  
NUIS : M12317004F  
TIRANË - ALBANIA

## V E N D I M

Nr. 2 date 20.12.2021

### I mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "FYDA" sh.p.k.

Sot në datën 20.12.2021 u zhvillua mbledhja e Ortakëve të shoqërisë tregtare FYDA SH.P.K. me NUIS M12317004F të cilët janë:

- **Z. Alfredo Colangelo**, nënshtetas italian, i lindur në datën 07.12.1954 në Pescara i cili zotëron 50% të kuotave të "FYDA" shpk.
- dhe
- **Z. Mohamed Dosukey Mohamed Ibrahim Aman**, nënshtetas egjiptian, i lindur në datën 17.11.1986 në Kajro, i cili zotëron 50% të kuotave të "FYDA" shpk.


Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në zbatim të nenit 15 të Statutit të shoqërisë, me unanimitet

#### Vendosi:


1. **Transferimin me dhurim të 50 % të kuotave të shoqërisë në pronësi të ortakut Alfredo Colangelo tek ortakun Mohamed Dosukey Mohamed Ibrahim Aman.**
2. Si rezultat i këtij transferimi
  - a. **100% e kuotave të shoqërisë zotërohen nga z. Mohamed Dosukey Mohamed Ibrahim AMAN**
  - b. **z. Alfredo COLANGELO nuk është më ortak i shoqërisë FYDA shpk**
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Autorizohet znj. Brisilda Sakiqi me numër personal J76206040A për të paraqitur dokumentacionin përkatës dhe kryer veprimet e nevojshme për regjistrimin e ndryshimit në Qendrën e Regjistrimit të Biznesit, brenda 30 ditëve.


ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Ortaku

  
\_\_\_\_\_  
Z. Alfredo Colangelo

Ortaku

  
\_\_\_\_\_  
Z. Mohamed Dosukey Mohamed Ibrahim Aman



Datë 21.12.2021

## V E N D I M

Administratori

**Objekti:** Ndryshime në të dhënat e regjistrimit në QKB, lidhur me adresen e selisë së FYDA SHPK

Administratori i FYDA SH.P.K, me NUIS (NIPT) M12317004F themeluar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi,

- **Z. Mohamed Dosukey Mohamed Ibrahim Aman**, nënshtetas egjiptian, i lindur në datën 17.11.1986 në Kajro


sot në datën 20.12.2021, bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 17 të Statutit të FYDA SH.P.K.

### Vendosi:

1. **Ndryshimin e adreses se Selise se FYDA SHPK**, duke deklaruar si adrese te re selie adresen **Rruga Mihal Grameno, Tirane**, bazuar ne kontraten e qirase te lidhur nga FYDA SHPK dhe qiradhenesi Z. Suljeman Laze (bashkelidhur kontrata e Qirase)
2. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.
3. Për njoftimin dhe regjistrimin e këtij vendimi në Qendrën e Regjistrimit të Biznesit dhe strukturat e tjera administrative autorizohet znj. Brisilda Sakiqi brenda 30 ditëve.

FYDA SH.P.K

Administrator



Mohamed Dosukey Mohamed Ibrahim Aman





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER LINDITA A. DURMISHAJ  
ADRESA Rruga "Petro Nini Luarasi"  
Pall. Gora, Nr. 12, Njësia Administrative  
Nr. 2, TIRANË  
TEL: 0682097661

## KONTRATË QIRAJE

(PASURI TË PALUAJTSHME)

Nr. repertori: 1945

Nr. koleksioni: 635/4

Tirane më 09/12/2021



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021051110059039824

\*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER LINDITA A. DURMISHAJ



A2001061110069089824

Repertori Nr. 1845  
Kolesioni Nr. 635/4

KONTRATË QIRAJE  
(Pasuri e Paluajtshme)

Sot, më datë 09.12.2021, para meje Noter Lindita A. Durmishaj, Anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën: Rr. "Petro Nini Luarasi", Pall. Gora, Njësia Nr. 12, Kati Përdhe, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë u paraqitën personalisht:

A. PALËT NË KONTRATË:

PALA QIRADHËNËSE:

**Sulejman Laze**, atësia: Baki, amësia: Dife, lindur në Novaj, Skrapar, në datë 07/03/1956 dhe banues në SKRAPAR, me adresë: Lazellar 00230018; Nd. 28; H. 1; Bogovë; Novaj; 5405; Skrapar, shtetas shqiptar, madhor, gjendja civile "i martuar", me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit/ës u sigurova me Leternjoftim ID, numër dokumenti 034894381 dhe numër personal F60307104W, lëshuar nga MPB në datë 10/10/2019 i vlefshëm deri në datë 09/10/2029.

PALA QIRAMARRËSE:

**Shoqëria FYDA SH.P.K.**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS M12317004F, datë 17/11/2021; me seli në Tiranë, me adresë Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Andon Zako Çajupi, Ndertesa 2, Hyrja 13, Ap.8, Kodi Postar 1019, përfaqësuar nga **Administratoret:**

**Alfredo Colangelo**, atësia Lucio, amësia Elena, shtetas Italian, lindur në Pescara (PE), Itali dhe banues në Pescara (PE), Itali, me adresë Rruga Marco Polo, N. 14, Pescara (Pe), Itali, lindur më 07/12/1954, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim Italian nr. CA57806JC dhe numër Kodi Fiskal CLNLRD54T07G482, lëshuar në datë 22.06.2021,

**Mohamed Ibrahim Aman**, atësia Dosukey, amësia Attyat, shtetas Egjiptian, lindur në Cairo, Egjipt dhe banues në Cairo, Egjipt, me adresë Cairo, Egjipt, lindur më 17/11/1986, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporten nr. A27156704, lëshuar në datë 09/07/2020.

Gjate redaktimit të kësaj kontrate, në baze të ligjit 110/2018, "PËR NOTERINË", nga perkthyesi zyrtar i licensuar nga Ministria e Drejtësisë si perkthyes i gjuhës italiane, u asistuan nga Z. Spiro Samarxhi, me identitet si më poshte.

B. TË DHËNA PËR PASURINË OBJEKT KONTRATE

Pala qiradhënëse është pronare e pasurisë vijuese:

Njësi, me sipërfaqe totale 83.6 m<sup>2</sup>, me adresë të pasurisë në Rrugen "Mihal Grameno", Tiranë. Pronësia në emër të blerësit është regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, me numër pasurie 3/376-N5, ZK. 8160, vol. 22, fq. 224. Të drejtën e pronësisë mbi pasurinë objekt kontrate pala qiradhënëse e vërteton me Çertifikatë për Vërtetim Pronësie, lëshuar në datë 28.04.2005 nga ZVRPP Tiranë.



A2021051110059039824

### C. OBJEKTII I KONTRATËS

Dhënia me qira e pasurisë së paluajtshme të specifikuar në pikën B/Të dhëna për Pasurinë objekt kontrate per kryerjen e aktivitetit "Bar Restorant", sipas kushteve të kontratës të përcaktuara ne pikën E të kontratës, si më poshtë vijon :

### E. KUSHTET E KONTRATËS:

C.1. Kjo kontratë qiraje lidhet për një periudhë kohë 5 (pese) vjeçare dhe i fillon efektet e veta në datën 01.01.2022 dhe i përfundon në datë 31.12.2026, me te drejte perseritje.

C.2. Palët deklarojne se çmimi i qirasë neto për gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate do të jetë 500 (peseqind) euro në muaj.

Ne marreveshje te paleve, cmimi i qirasë, do të paguhet cdo muaj midis datave 1-5 çdo muaji për vete muajin. Palet deklarojne se ne ditën e nenshkrimit te kesaj kontrate pala qiramarrëse i ka paguar kesh, jashte kesaj zyre noteriale, garanci ne vleren e qirase se gjashte muajve, ne shumen 3.000 Euro garanci qe do te sherbej per efekt demshperblimi, ne rast se gjate periudhes se qirase pala qiramarrëse i shkakton deme prones, deme qe nuk vijne nga konsumi i zakonshem i prones. Ne rast se pala qiramarrëse nuk i shkakton deme prones, garancia ne fund te marredhenies se qirase i kthehet e plote, pales qiramarrëswe nga pala qiradhenese.

C.3. Pala qiradhënëse deklaron dhe garanton palën qiramarrëse se është pronare e ligjshme e pasurisë objekt kontrate, ka të drejte të lidhë këtë kontratë qiraje dhe se prona është e pangarkuar me kufizime mbi pasurine. Gjithashtu qiradhenesi merr persiper zgjidhjen e cdo pretendimi te mundshem te paleve te treta ne raport me pronen objekt kontrate, pa perfshirjen e pales qiramarrëse ne konflikte te mundshme qe mund te lidhen me keto pretendime.

C.4. Pala qiradhenese deklaron se nuk lejon asnjë lloj ndyshimi në strukturen e objektit pa lejen me shkrim të qiradhënësit dhe gjatë gjithë periudhës që kjo kontratë do të jetë në fuqi, pala qiramarrëse duhet ta mirëmbajë dhe ta dorëzoje pronën në gjendje të mirë në përfundim të kontratës.

C.5. Shpenzimet e energjisë elektrike, ujit, ambienteve të përbashkëta, telefonisë, internetit dhe tatimi ne burim per te ardhurat nga qiraja, ne marreveshje te paleve, eshte dakordesuar te paguhen nga pala qiramarrëse.

C.6. Qiramaresi deklaron se do te marre ne posedim pasurine objekt kontrate, ne gjendje te mire ne daten 10.12.2021, se do ta perdore ate per qellime te ligjshme, dhe se do te demshperblej palen qiradhenese per cdo demtim te mundshem te prones, demtim qe nuk do te vij nga amortizimi i zakonshem i prones per shkak te perdorimit te saj sipas kesaj kontrate. Palet pranojne se pala qiradhenese nuk njeh asnje shpenzim te pales qiramarrëse per ta pershtatur ate per nevojat e veta te perdorimit, me te drejten e kesaj te fundit qe ne përfundim te marredhenies se qirase te mund te heqe nga prona investimin e levizshem por jo investimin qe eshte i lidhur ne menyre te qendrueshme me pronen.

C.7. Me përfundimin e afatit të mësipërm, ne ditën qe kjo kontrate qiraje mbaron efektet e veta, pala qiramarrëse detyrohet të lirojë pa asnjë njoftim pasurine objekt kontrate përveç rastit kur ndërmjet tyre është bërë ne marreveshje zgjidhje e kontratës përpara afatit apo është bërë një marrëveshje për rinovimin e kësaj kontrate per nje periudhe te dyte.

C.8. Palet kane rene dakord se pala qiradhënëse, ka të drejtë të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme, përpara afatit, vetem në rast se pala qiramarrëse nuk paguan qiranë qofte dhe per një muaj te vetem, dëmton rënde apo nuk e përdor pasurinë për motive të arsyeshme dhe të ligjshme. Në këto raste, në momentin e konstatimit të një apo disa prej rasteve të mësipërme, pala qiradhënëse, nëpërmjet një kujtese noteriale, i kërkon

Fq. 2



A2021031110039039824

palës qiramarrëse që të paraqiten përpara noterit për të bërë zgjidhjen e kontratës si dhe i kërkon qiramarrësit lirim të menjëhershëm të pronës. Në rast se pala qiramarrëse, nuk pranon të paraqitet përpara noterit për zgjidhjen e kontratës si dhe nuk liron ambientin objekt i kësaj kontrate brenda afatit të përcaktuar në Kujtesën Noteriale, si parashikohet me lartë, pavaresisht shkeljeve të bera prej saj, pala qiradhenese, për të evituar konfliktet e mundshme mes paleve, ka të drejtë që në prani të deshmitareve dhe/ose punonjësve të rendit dhe/ose perfaqesuesve të njesise administrative, të beje lirim të ambientit (në prani apo mungese të pales qiramarrëse), të nderoj celesat e pronës, dhe të nxjerre jashtë pronës së saj, sendet e qiramarrësit, nëse do të ketë të tilla në pronë. Pala qiradhenese nuk përgjigjet për ruajtjen e sendeve pas nxjerrjes së tyre nga prona objekt kontrate. Për veprimet e mesipërme mbahet procesverbali përkatës që nënshkruhet nga të pranishmit. Pas veprimeve të mesipërme pala qiradhenese ka të drejtë të paraqitet përpara noterit për të bërë deklaratë noteriale ku të deklaroj zgjidhjen e njëanshme të kontratës së qirase. Pas nënshkrimit të Deklaratës noteriale pala qiradhenese është e lire të kontraktot pasurine objekt kontrate me persona të tretë.

C.9. Në rast se për shkak të investimit dhe punës së pales qiramarrëse në menaxhimin e aktivitetit, xhiro e lokalit do të rritet në 6.000 euro ose më lartë atëherë palet kanë rënë dakord që pala qiramarrëse të ketë të drejtë ta japë pasurine objekt kontrate me nenqira të persona të tretë (me pelqimin paraprak të qiradhenësit vetëm për sa i përket zgjedhjes së personit por jo cmimit të nenqirase), me një qira me të lartë se 500 Euro në muaj, me kushtin që detyrimi për të paguar cmimin e qirase prej 500 euro në favor të pales qiradhenese të ngelet detyrim i pales qiramarrëse në këtë kontratë dhe jo i nenqiramarrësit.

C.10. Kjo kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar, çdo çështje që nuk gjen rregullim në këtë kontratë do të rregullohet sipas dispozitave të Kodit Civil për qirane.

C.11. Për çdo konflikt që mund të lindë mes paleve në lidhje me këtë kontratë dhe që nuk do të zgjidhet me mirekuptim mes tyre, kompetente për shqyrtimin e mosmarreveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

C.12. Kjo kontratë përben marreveshje të plote midis paleve.  
Diskutimet verbale dhe parashtrimet e bera gjatë negociimit për lidhjen e saj nuk përbejnë kushte të kësaj kontrate. Çdo ndryshim apo shtesë e kushteve të kësaj kontrate do të jetë i vlefshëm vetëm pasi të jetë nënshkruar nga palet dhe vertetuar nga noteri.

Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", une noterja deklaroj se do të ruaj dhe do të përpunoj të dhënat personale të paleve të kësaj kontrate në mënyrë të drejtë e të ligjshme.

Kjo Kontratë e redaktuar prej meje në gjuhën shqipe, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të paleve, për Palën Qiradhenëse Z. Sulejman Laze në gjuhën shqipe, ndërsa duke qënë se Pala Qiramarrëse perfaqesuar nga Z. **Alfredo Colangelo**, dhe Z. **Mohamed Ibrahim Aman** është janë shtetas italian dhe egjiptian, ky i fundit e njëjshëm mirë njehen italiane dhe nuk e kupton gjuhën shqipe, leximi i kontratës në gjuhën italiane u bë nga Z. **Spiro Samarxhi**, atësia: Thodhori, lindur në Vlorë në datë 17.11.1985 dhe banues në Njësia Administrative Nr. 5, Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e së cilit u binda në bazë të letërnjoftimit me numër letërnjoftimi 034032964, numër personal I51117067R, lëshuar në datë 13.03.2019, me numër NUIS M01824014N, përkthyes i autorizuar për përkthim zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, i Gjuhës Italiane.



A2021051110039039824

Palët, pasi leximit të kontratës në gjuhën që ata kuptojnë, më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen dhe efektet e saj juridike dhe meqenëse shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.



Përkthyes Zyrtar Spiro Samarkhi

PALE QIRAMARRËSE: Subjura Ise

PALA QIRAMARRËSE: Shoqeria "FYDA", shpk, perfaqesuar nga

ALFONSO COLANGELO

Mohamed dosukay Mohamed Ibrahim Aman

Unë Noterja e bindur për identitetin dhe vullnetin e lirë e të pavesuar të palëve si dhe për ligjshmërinë e Aktit, në bazë të neneve 801-825 të Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil" (i ndryshuar), Ligjit 110/2018, "PËR NOTERINË", si dhe Udhëzimit numër 23, datë 07.12.2020 të Ministrit të Drejtësisë e vërtetoj atë në gjashtë kopje origjinale me vlerë të njëjtë, një prej të cilave arkivohet dhe administrohet në këtë zyrë noteriale, një kopje i vihet në dispozicion palës qiradhënëse dhe 4 kopje i vihen në dispozicion palës qiramarrëse.

NOTER



Mehed dosukay





# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

## ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit TIRANE Zona Kadastrale Nr. 0160  
 Numri i Pasurisë 3/376-N5 Volumi 22 Faqe 224  
 Adresa e Pasurisë Rr. M. GRAMENO, TIRANË  
 Lloji i Pasurisë NJESI  
 Sipërfaqja Totale 03,6 m<sup>2</sup>  
 Nga kjo : Sa Truall \_\_\_\_\_ Nga kjo : Sa Ndërtesa \_\_\_\_\_  
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes \_\_\_\_\_ %

### KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR DË

Zoti ( Zotërinjtë )

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>SULEJMAN BAKI</u>	<u>LAZË</u>		<u>I</u>	<u>Rr. M. GRAMENO, TIRANË</u>
-	-	-	-	-
-	-	-	-	-
-	-	-	-	-
-	-	-	-	-

- është pronar i PASURISË 3/376-N5
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart \_\_\_\_\_
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi \_\_\_\_\_
- kufizimet e pasurisë janë : V \_\_\_\_\_, L \_\_\_\_\_, J \_\_\_\_\_, P \_\_\_\_\_

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.


Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (ë) interesuari (t) më datë 28.04.05 Nr. 2304/5

Data e lëshimit të çertifikatës

28.04.2005

Lëshuesi i çertifikatës  
REGJISTRUESI

(GAZMENI ZENBU)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

## CERTIFIKATË REGJISTRIMI

NUMRI SERIAL:  
SN-781800-11-21

Personit të tatueshëm:

FYDA

Statusi

Aktiv

Me adresë kryesore

Tirane, Tirane, TIRANE, Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga Andon Zako Çajupi, Nderitesa 2, Hyrja 13, Ap.8, kodi postar 1019

I jepet ky numër identifikimi (NUIS)

M12317004F

Afati i veprimtarisë

Nga : 10/11/2021 deri

DATA E REGJISTRIMIT

17/11/2021

DATA E LËSHIMIT

19/11/2021

SPORTTELI SHËRBIMIT:




Vëlbuar elektronikisht nga Qendra  
Kombëtare e Biznesit  
Data: 20211119 15:37:53 +02'00'  
M12317004F2021111915373951006

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vëlbuar me anë  
te një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

(Faqe 1, Mbiemri) i nëpunësi të sportetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E  
SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"**

**GJENDJA E REGJISTRIMIT**

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M12317004F
2. Data e Regjistrimit	17/11/2021
3. Emri i Subjektit	FYDA
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	16/11/2021
6. Kohëzgjatja	Nga: 10/11/2021
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Andon Zako Çajupi, Ndertesa 2, Hyrja 13, Ap.8, kodi postar 1019
8. Kapitali	10.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Bar - Kafe, Restorant, fjetje dhe mengjes (B&B). Tregti me shumice dhe pakice brenda dhe jashte vendit te gjithë artikujve ushqimore, duhanit, pijeve alkolike e joalkolike, eneve te kuzhines dhe aksesoreve te tyre etj. Hapje e marketeve e furrave te bukes si dhe rrjeteve te tyre ne te gjithë vendin. Organizim eventesh argetuese dhe artistike, kurse muzike dhe arti. Çdo veprimtari tjetër brenda kufijve te parashikuar ne legjislacionin ne fuqi dhe aktivitete te tjera qe ndihmojne shoqerine ne rritjen e objektit te saj fitimpures.
10. Administratori/ët	Alfredo Colangelo
10.1 Afati i emërimit	Nga: 16/11/2021 Deri: 16/11/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	Administrim veç e veç dhe me kompetenca te plotë e të barabarta
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	
12. Administratori/ët	Mohamed Dosukej Mohamed Ibrahim Aman
12.1 Afati i emërimit	Nga: 16/11/2021 Deri: 16/11/2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	Administrim veç e veç dhe me kompetenca te plotë e të barabarta	
13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
14. Ortakët	Alfredo Colangelo	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 5.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
14.4 Komente (nëse ka)		
15. Ortakët	Mohamed Dosukej Mohamed Ibrahim Aman	
15.1 Vlera e kapitalit	Para: 5.000,00	Natyre:
15.2 Numri i pjesëve	1,00	
15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
15.4 Komente (nëse ka)		
16. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
17. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: FYDA E-Mail: fyda.iteg21@gmail.com Telefon: 0695374928	
18. Statusi:	Aktiv	

Datë: 09/12/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga  
Qendra Kombëtare e Biznesit  
Date: 2021/12/09 13:40:22 +01:00  
M12317004F2021120913401112  
2006

2

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)